

## GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

P.nr. 42/2012

25 Mars 2013

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS**, në trupin gjykues të përbërë prej Gjyqtares së EULEX-it Roxana Comsa si Kryetare e Trupit Gjykues, Gjyqtares së EULEX-it Katja Dominik dhe Gjyqtarit të EULEX-it Timo Vuojolahti, me Zyrtarin Ligjor të EULEX-it John Gayer si procesmbajtës në lëndën penale kundër:

**RB, FT, AC, FA dhe LK**, të akuzuar sipas Aktakuzës së ndryshuar të Prokurorit Publik PP. 117/2011 të datës 16 Korrik 2012 dhe ndryshuar më 21 Janar 2013 dhe të paraqitur në Shkrimoren e Gjykatës Themelore të Mitrovicës konfirmuar me Aktvendimin për konfirmimin e Aktakuzës të datës 26 Korrik 2012 për bashkë-kryerje të veprës **Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge** sipas Neneve 23 dhe 229(4)(1) të Kodit Penal të Kosovës (KPK) apo Neneve 31 dhe 273(2) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK),

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor të hapura për publikun me 21 deri 24 Janar dhe 28 Janar 2013 të gjitha në prani të të Akuzuarve **RB, FT, AC, FA dhe LK**, të Avokatëve përkatës mbrojtës Vehbi Beqiri Estat Gutaj, Abit Asllani, Kadri Osaj dhe Rexhep Kaçaniku, dhe të Prokurores Publike të EULEX-it Nina Grande, pas këshillimit dhe votimit të Trupit Gjykues të mbajtur më 29 Janar 2013, sipas Neneve 363 deri 366 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP), ka shpallur publikisht dhe në prani të të akuzuarve, Avokatëve Mbrojtës dhe Prokurores Publike të EULEX-it këtë:

### AKTGJYKIM

Të Akuzuarit

**RB**

Në paraburgim është mbajtur nga data 18 Mars 2012 deri 17 Shtator 2012 para se të vendoset në arrest shtëpiak.

Dhe

**FT,**

Nuk ka dënime paraprake dhe është mbajtur në paraburgim nga data 18 Mars 2012 deri më 17 Shtator 2012 para se të vendosej në arrest shtëpiak deri më 17 Janar 2013.

## **SHPALLEN FAJTOR**

Sepse,

**Të Akuzuarit së bashku dhe në bashkë-kryerje me së paku një person tjetër të panjohur kanë organizuar blerjen e 5546.4g (pasha neto) marihuanë dhe transportin e saj nga Smrekovnica deri në Mitrovicë me synim të shpërndarjes së mëtejshme dhe dërgimit. Policia e ka sekuestruar këtë sasi më 18 Mars 2012 në Mitrovicë.**

Prandaj

**Të Pandehurit RB dhe FT janë fajtorë për akuzën penale bashkë-kryerje e veprës Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe**

**analoge** sipas Neneve 31, 273(2) dhe 281 (1.1) të KPRK sipas Nenit 3(2) të KPRK, sipas Nenit 365 të KPP.

Të Akuzuarit dënohen:

## **DËNIMI**

**RB** dënohet me gjobë prej 30 euro dhe 1 vjet e 6 muaj burgim sipas Neneve 74(3.10), 76(1.3), 273(3) dhe 281(1) të KPRK.

**FT** dënohet me gjobë prej 20 euro me 1 vit burgim sipas Neneve 74(3.10), 76(1.3), 273(3) dhe 281(1) të KPRK.

Në përputhje me Nenin 83(1) të KPRK periudha e qëndrimit në paraburgim dhe arrest shtëpiak duhet të përfshihet në llogaritjen e dënimit. Të dy të akuzuarit janë mbajtur në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 18 Mars 2012 deri më 17 Janar 2013.

Të Akuzuarit

**AC**

Është mbajtur në paraburgim që nga data 6 prill 2012.

Dhe,

**FA**

Në paraburgim ka qenë nga data 6 Prill 2012 deri më 17 Shtator 2012 para se të vendosej në arrest shtëpiak deri më 17 Janar 2013.

**SHPALLEN TË PAFAJSHËM**

**Të Pandehuri AC dhe FA nuk janë fajtor dhe lirohen nga akuza penale për bashkëkryerje nga grupi të veprës Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge sipas Neneve 31, 273(2) dhe 281 (1.1) të KPRK sipas Nenit 3(2) të KPRK, sipas Nenit 364(1.3) të KPP.**

Të Akuzuarit

**LK**

Në paraburgim ka qenë nga data 18 Mars deri më 11 Maj 2012 dhe që nga atëherë ka qenë në arrest shtëpiak deri më 17 Janar 2013.

i,

**REFUZOHET AKUZA**

**I Pandehuri LK** e ka akuzën penale bashkë-kryerje nga grupi të veprës **Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge** sipas Neneve 31, 273(2) dhe 281 (1.1) të KPRK sipas Nenit 3(2) të KPRK, sipas Nenit 363(1.1) të KPP

### **SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE**

Sipas Nenit 451(1) dhe (3) të KPP, të Akuzuarit **RB** dhe **FT** detyrohen me nga 70 euro për shpenzimet e procedurës penale.

Sipas Nenit 451(1) dhe (3) të KPP, shpenzimet e nevojshme të Pandehurve **AC**, **FT** dhe **LK**; dhe pagesa dhe shpenzimet e nevojshme të Avokatëve Mbrojtës si dhe shpenzimet e përkthimit gojor dhe me shkrim do të paguhen nga burimet buxhetore.

### **KONFISKIMI**

Në përputhje me Nenin 69 të KPRK urdhërohet që të konfiskohen këto:

1. 5546.4g (neto) e drogës së sekuestruar. Kjo do të asgjësohet.
2. Vetura Mercedes me ngjyrë të bardhë (regjistrimi 02-197-AG)
3. Telefon Samsung me ngjyrë të zezë (IMEI 352025/04/978394/2)
4. SIM kartelë e IPKO-së për nr. 049 425 895 (SIM kartela nr. 107010520941)
5. Telefon Sony Ericsson me ngjyrë të bardhë (IMEI 35791301-704853-2)
6. SIM kartelë e IPKO-së për nr..049 496 595 (SIM kartela nr. 109011667200)
7. Telefon Nokia me ngjyrë të zezë (IMEI 355956/04/366377/6)

8. VALA SIM Kartelë për nr.044 218 808 (SIM kartela nr 8937701010011760689)
9. Telefon Nokia me ngjyrë të zezë (IMEI 356841/02/844547/3)
10. SIM Mobtel për nr..065 5777 631 (SIM kartela nr. 89381030000144638097)
11. SIM kartelë Vodafone (SIM kartela nr. 60610988028631G01520)
12. SIM kartelë VALA (SIM kartela nr. 89377010100016521508)
13. SIM kartelë Mobtel (SIM kartela nr. 89381030000143222943)

## **Arsyetim**

### A. Historia procedurale

1. Më 16 Korrik 2011 Prokurori Publik i Qarkut të Mitrovicës ka ngritur Aktakuzën PP.nr. 117/2011 të datës 16 Korrik 2011, me të cilën akuzohen të Akuzuarit për veprën Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e drogave narkotike të rrezikshme dhe substancave psikotrope sipas Nenit 229(2) dhe (4)(1). Më 21 Janar 2013 Aktakuza është ndryshuar gjatë shqyrtimit gjyqësor për ta futur bashkë-kryerjen sipas Nenit 23 të KPK dhe për të reflektuar futjen e Kodit të ri Penal të Republikës së Kosovës (2012) (Nr. i kodit 04/L-082) (ÇRK), d.m.th. referimit të Neneve 31 dhe 273(2) të KPRK.
2. Më 13 Gusht 2012 Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ua ka caktuar lëndën Gjyqtarëve të EULEX-it në pajtim me Nenin 3.3 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr.. 03/L-053).
3. Shqyrtimi Gjyqësor është mbajtur më 21 deri 24, 28 dhe 29 Janar 2013 ku aktgjykimi është shpallur më 29 Janar 2013.

### B. Kompetenca

4. Vepra bie në kompetencë territoriale dhe lëndore të Gjykatës Themelore të Mitrovicës. Vepra Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e drogave narkotike të rrezikshme dhe substancave psikotrope dhe analoge nga Neni 229(2) dhe (4)(1) i KPK tani Neni 273 i KPRK përcaktohet me KPP në kuadër të juridiksionit ekskluziv të Departamentit për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore në shkallë të parë si vepër që mbart dënimin maksimal më të madh se 10 vjet dhe konsiderohet si një krim i rëndë (shiko Nenet 11 dhe 15(1.21) të Ligjit për Gjykatat, Ligji nr. 03/L-199; dhe Nenet 21(4) dhe 22(1.68) të KPP). Me që vepra është kryer pjesërisht në Komunën e Mitrovicës, aji bie në kompetencë territoriale të Gjykatës Themelore të Mitrovicës sipas Nenit 29(2) të KPP.

C. Provat e pranuara në shqyrtimin gjyqësor

5. Provat e dhëna në listën e mëposhtme janë konsideruar si të pranueshme në shqyrtimin gjyqësor pas një vlerësimi të besueshmërisë, rëndësisë dhe vlerës dëshmuese të tyre në përputhje me Nenin 260(2) dhe (3) të KPP.
6. Deklaratat e të pandehurve dhe të dyshuarve, procesverbalet apo raportet në vijim:
  1. Kallëzimi penal i datës 19 Mars 2012,
  2. Raporti i Policit i datës 18 Mars 2012, nga Polici i PK Mensur Krasniqi (Nr. i PK 7947),
  3. Raporti informues pa datë nga Polici i PK Musli Hoxhaxiku (Nr. i PK. 7944),
  4. Procesverbali nga intervista e të dyshuarit **FA** i datës 18 Prill 2012,
  5. Intervista e të dyshuarit **RB** e datës 19 Mars 2012,
  6. Procesverbali nga intervista e të Pandehurit **FT** i datës 2 Maj 2012,
  7. Intervista e të dyshuarit **FT** e datës 19 Mars 2012,
  8. Procesverbali nga intervista e të Pandehurit **RB** i datës 2 Maj 2012,
  9. Procesverbali nga intervista e të Pandehurit **FA** i datës 3 Maj 2012,
  10. Procesverbali nga intervista e të Pandehurit **AC** dated 3 May 2012,
  11. Procesverbali nga intervista e të Pandehurit **LK** i datës 3 Maj 2012,
  12. Intervista e të dyshuarit **LK** e datës 19 Mars 2012,
  13. Memo zyrtare nga Polici Avni RB (Nr. i PK 0384) e datës 2 Prill 2012, dhe
  14. Intervista e të dyshuarit **AC** e datës 8 Prill 2012.
7. Urdhrat hetimor, masat dhe raportet në vijim:
  1. Memo zyrtare nga Rr. Hekuran Mehmeti e datës 12 Mars 2012,
  2. Urdhri i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës i datës 12 Mars 2012,
  3. Memo zyrtare nga Polici i PK Musli Hoxhaxhiku (Nr. i PK 7944) e datës 9 Mars 2012,
  4. Urdhri i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës i datës 7 Mars 2012,
  5. Memo zyrtare nga Polici i PK Mensur Krasniqi (KP nr 7947) e datës 7 Mars 2012,
  6. Urdhri i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës i datës 21 Shkurt 2012,
  7. Rezultati i përgjimeve të **RB** (Shqip dhe Anglisht) nga data 7 deri 18 Mars 2012, dhe
  8. Të dhënat e telefonit IPKO të datës 7 dhe 12 Mars 2012.
8. Materiali dhe raportet tjera në vijim:
  1. Kopja e pasaportës së **AC**,
  2. Certifikata e gjësendeve të konfiskuara nga **RB** e datës 18 Mars 2012,
  3. Dëftesë për konfiskimin e përkohshëm të gjësendeve nga **AC** e datës 8 Prill 2013,
  4. Lista e provave e datës 17 [sic] Mars 2012,
  5. Fotoalbumi i datës 18 Mars 2012,
  6. Aktvendimi i Gjykatës Themelore të Shkupit i datës 17 Mars 2012 mbi fillimin e hetimeve,
  7. Certifikata e konfiskimit e datës Mars 2012,

8. Shënimet nga fletorja e **RB** pa datë (përveç fjalisë së dytë të dorëshkrimit në fund të faqes),
  9. Raporti i ekspertizës së analizës Kimike të Agjencionit Kosovar të Forenzikës i datës 2 Maj 2012 (Njësia e Shkencave të Forenzikës), dhe
  10. CD-ja e përgjimeve.
9. Gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë dhënë deklarata këta dëshmitarë:  
**NB** më 22 Janar 2013 (lidhur me të dhënat e aktiviteteve të ndryshme hetimore); dhe  
**SD** më 23 Janar 2013 (lidhur me ekzaminimin e substancave narkotike).
10. Gjatë shqyrtimit gjyqësor janë bërë këto propozime për papranueshmërinë e provave nga Palët dhe janë vlerësuar nga Trupi Gjyqësor:

Më 22 Janar 2013 **FA** ka paraqitur një propozim për ta përjashtuar intervistën e tij dhënë policisë si të papranueshme. Është pohuar se atij nuk i janë lexuar të drejtat e tij dhe kjo tregohet me faktin se nuk e kishte nënshkruar kutinë e ndarë për ta konfirmuar këtë. Kjo është refuzuar nga Trupi Gjyqësor më 23 Janar 2013. Vendi i saktë i nënshkrimeve nuk është i përcaktuar me ligj. Faktet rreth intervistës është dashur të jenë të qarta. Edhe i Pandehuri edhe avokati i tij mbrojtës kanë nënshkruar në fund të çdo faqeje, duke përfshirë aty ku janë paraqitur të drejtat e të Pandehurit. Avokati i **AC** i ka nënshkruar gjithashtu edhe procesverbalet dhe nuk ka ngritur ndonjë kundërshtim për intervistën dhe si ishte zhvilluar ajo në atë kohë.

Më 23 Janar 2013 **RB** ka sfiduar pranueshmërinë e të dhënave të fletores të gjetura tek ai kur është arrestuar. Në fund të shënimit një polic i paidentifikuar kishte shkruar dy fjali. E para ka cekur se prek kujt ishte sekuestruar letra ndërsa e dyta ka spekuluar rreth kuptimit të shënimit në fletore. Trupi Gjyqësor e ka aprovuar pjesërisht. Shënimi në fletore do të jetë i pranueshëm. Megjithatë, shënimi i shtuar nga një zyrtar policor i paidentifikuar ishte i pranueshëm vetëm për atë që ka luajtur rolin e identifikimit për zinxhirin e provave. Fjalja e dytë e shënimit i atribuohet spekulimit dhe është provë thelbësishme e pabesueshme dhe kështu e papranueshme sipas Nenit 259(2) të KPP.

D. Assessment of the presented evidence:

11. Për shkak të hartimit të aktakuzës Gjykata kufizohet në ngjarjet dhe dërgesën narkotike të 18 Marsit 2012.

Faktet e pakontestueshme

12. Sekuestrimi i 5.546 neto Kg. Lëndë narkotike (kanabis) nga vetura që shfrytëzohej nga **RB** më 18 Mars është i pakontestueshëm (Kallëzimi Penal i datës 19 Mars 2012; raporti

i policit i datës 18 Mars 2012 nga Polici i PK Mensur Krasniqi (Nr. i PK. 7947); Procesverbali nga shqyrtimi gjyqësor i datës 22 Janar 2013 për **NB** (NB Shqyrtimi gjyqësor) faqe10; Raporti i ekspertizës së analizës Kimike të Agjensionit Kosovar të Forenzikës i datës 2 Maj 2012 (Njësia e Shkencave të Forenzikës) (Raporti i Analizës Forenzike) faqe.2, Lista e Provave D1.1 deri D1.6; dhe fotografitë e Fotoalbumit me numër 4 deri 21).

13. Është gjithashtu e pakontestueshme që substancat e sekuestruara nga **RB** ishin lëndë narkotike ( Raporti i Analizës Forenzike; dhe procesverbali nga shqyrtimi gjyqësor i datës 23 Janar 2013 për **SD** (SD Shqyrtimi gjyqësor) faqe 3).
14. Narkotikët e sekuestruar janë narkotikë të ndaluar sipas Neneve 9.1 dhe 9.2 dhe Tabelës I të Ligjit për Barna Narkotike, substanca Psikotrope dhe Prekursorë (Ligji Nr. 02/L-128) (BNSPP). Dhe asnjëri nga të Pandehurit nuk ka pohuar se posedonte leje të vlefshme sipas BNSPP e cila do ta autorizonte shitjen, shpërndarjen, transportin, posedimin apo përdorimin e narkotikëve.
15. Furnizuesi i narkotikëve pretendohet se ishte një Shqipëtar (Shqiptari) i cili transportonte dhe shiste narkotikë në Kosovë. **RB** e kishte takuar këtë person në Mitrovicë në një “auto-larje” tri javë para arrestimit të tij më 18 Mars 2012 (Procesverbali nga Intervista e të Pandehurit **RB** e datës 2 Maj 2012 (RB i Pandehur) faqe.2; dhe procesverbali nga shqyrtimi gjyqësor i datës 23 Janar 2013 për **RB** (RB shqyrtimi gjyqësor) faqe 18). Më pas kishte bërë plane të fshehta me **FTn** për të blerë narkotik nga Shqiptari dhe kishte rregulluar transaksionin (RB shqyrtimi gjyqësor faqe 18; RB Intervista e të Pandehurit faqe 3; Procesverbali nga intervista e të Pandehurit **FT** i datës 2 Maj 2012 (FD i Pandehur) faqe.3; dhe procesverbali nga shqyrtimi gjyqësor i datës 23 Janar 2013 për **FTn** (FD shqyrtimi gjyqësor) faqe 30).
16. Më apo para datës 16 Mars **FT** me njohuri të plotë se **RB** ka organizuar shitjen e narkotikëve te një tregtar droge me emrin Nenad (Intervista e të Dyshuarit **FT** e datës 19 Mars 2012 (FD i Dyshuar) faqe 3 dhe FD i Pandehur faqe 3).
17. Më apo para datës 16 Mars 2012 a një blerje dhe dërgesë e substancave narkotike ishte bërë ndërmjet **RB** dhe Shqiptarit për 3000 euro (RB shqyrtimi gjyqësor faqe 21). **RB** i ka paguar paratë në një takim në periferi të Prishtinës (RB intervista e të Pandehurit faqe 2 deri 4; RB shqyrtimi gjyqësor faqe.28; dhe raportet e përgjimit të datave 19 Mars 2012 për datën 16 Mars 2012 ora 12:11, 12:12 dhe 16:47). Substancat narkotike i janë dërguar **RB** në Smrekovicë përmes kuririt i cili kishte arritur me veturë dhe kishte vendosur qeset që përmbanin substanca narkotike në bagazhin e veturës që drejtohej nga **RB** (Mercedes i bardhë me regjistrim 02-197-AG) (RB shqyrtimi gjyqësor faqe 18). **RB** kishte transportuar drogat deri te supermarketi Viva Fresh në Mitrovicë ku ishte arrestuar (RB i Pandehur faqe 3; dhe RB shqyrtimi gjyqësor faqe 18). **FT** dhe **LK** janë arrestuar te supermarketi ETC në Mitrovicë ku po prisnin të takoheshin me RB (Raporti i Policit i datës 18 Mars 2012).
18. **FA** dhe **AC** janë vënë në paraburgim nga Policia më 6 Prill 2012 në Prizren.

19. Është e pakontestueshme se i Pandehuri **LK** nuk ishte i përfshirë në asnjë nga këto vepra dhe Prokurori kishte ndërprerë ndjekjen ndaj tij para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.

### Faktet në kontest

#### *Identiteti i Shqiptarit*

20. Prokuroria pohon se **AC** është furnizues “Shqiptar” i narkotikëve që kishte furnizuar narkotikët e sekuestruar në posedim të **RB**-së. Këtu u referohemi numrave të telefonit që besohet se janë përdorur nga **AC**. Këta numra lidhen me një hetim tjetër dhe një njeri të identifikuar si “Kuksi”, Shqiptari. Prokurori pohon se **AC** dhe Kuksi janë person i njëjtë.

21. **AC** pohon se nuk kishte pasur asnjë kontakt me **RB**, **FT** apo **LK** dhe asnjëherë nuk kishte qenë në Mitrovicë. Ai e mohon se është Kukse apo se importon substanca narkotike në Kosovë. Ai e pranon se e njeh **FA** por vetëm në bazë të një takimi të vetëm në Prizren dhe mohon se ka pasur ndonjë biznes apo lidhje të paligjshme me **FA**.

22. Asnjëri nga telefonat e sekuestruar nga **AC** nga Policia nuk korrespondon me ndonjë numër telefonik të përgjuar nga policia. Nuk ka prova tjera fizike apo të vëzhgimit për të vërtetuar rastin e Prokurorit se **AC** është furnizuesi Shqiptar i substancave narkotike me të cilin ishte në kontakt **RB**. Përveç **FA** asnjëri nga bashkë-të-pandehurit nuk e ka pranuar se kanë takuar më parë **AC**.

23. Gjykata ka parasysh takimin ndërmjet **AC** dhe **RB** që dëshmohet nga zyrtari policor **NB** informuar nga përgjimet telefonike. Polici **NB** pohon se e kishte parë **AC** dhe **RB** që ishin takuar afër rrethit të QMI më 16 Mars 2012 (NB shqyrtimi gjyqësor, faqe 15). Kjo korrespondon me dëshminë e RB se e kishte takuar furnizuesin e narkotikëve nga Shqipëria të një rreth në rrugën për Lipjan ku ishte finalizuar marrëveshja për narkotikë (RB i Pandehur faqe 2). Megjithatë, Gjykata nuk është në gjendje për të vënë peshë të konsiderueshme kësaj dëshmie mjaftueshëm për të konstatuar se është e vërtetuar. Të Pandehurit janë vëzhguar vetëm në këtë rast të vetëm, nuk ka prova të qarta për ta vërtetuar identifikimin e Policit **NB** dhe nuk ka ndonjë raport bashkekzistues apo tjetër që të ketë regjistruar

këto fakte para Gjykatës para dëshmisë së Policit **NB**. Edhe pse e rëndësishme, nuk vërtetohet se **AC** dhe **RB** kanë pasur ndonjë kontakt tjetër, kanë qenë në kontakt të rregullt apo takim lidhur me dërgesën e narkotikëve më 18 Mars 2012.

24. Gjykata nuk vë në pikëpyetje besueshmërinë dhe qëndrimin e Policit **NB** si zyrtar policor. Është shumë e dyshimtë që të dy të pandehurit e mohojnë këtë takim apo se e njohin njëri-tjetrin. Marrë me prova të tjera kjo nuk është e mjaftueshme për ta vërtetuar **AC** si furnizues të narkotikëve të dërgesës së 18 Marsit 2012. Ka dëshmi të pamjaftueshme të mbledhura gjatë hetimit dhe paraqitur nga prokuroria për të vërtetuar se **AC** është kontakti i narkotikëve nga Shqipëria i **RB**; apo që **AC** dhe **Kuksi** janë i njëjti person. Përgjimet telefonike janë jothelbësore dhe të pamjaftueshme vetvetiu për ndjekje.

#### *Lidhjet me furnizuesin e narkotikëve nga Shqipëria dhe të Pandehurit*

25. Vetëm **RB** e pranon se kishte pasur kontakt me furnizuesin e narkotikëve nga Shqipëria. Ata ishin takuar tri herë, herën e parë te autolarja në Mitrovicë, herën e dytë te supermarketi ETC në Fushë Kosovë dhe herën e fundit te rrethi në rrugën për Lipjan nga Prishtina (I Pandehuri **RB** faqe.2; dhe **RB** shqyrtimi gjyqësor faqe 20).

26. Pronësia e numrave në vijim ose pranohet nga **RB** ose është regjistruar zyrtarisht gjatë procedurës: 044-218-808, 049-496-595, 049-425-895 (shiko **RB** I Dyshuar faqe 2; **RB** shqyrtimi gjyqësor faqe 17; të dhënat e telefonike të IPKO-së të datës 12 Mars 2012 dhe Certifikatën e gjësendeve të konfiskuara nga **RB** e datës 18 Mars 2012). **RB** e mohon pronësinë e 049 496 595 të cilën Gjykata e refuzon sepse SIM kartela për këtë numër ishte konfiskuar nga ai me rastin e arrestimit. Në bazë të urdhrave të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës të datave 21 Shkurt dhe 7 Mars 2012 përgjimet gjithashtu vërtetojnë se numri 049-820-521 lidhet me **RB**, të cilën gjë e mohon gjithashtu. I njëjti telefon ka përdorur SIM kartelat për numrat 049-820-521 dhe 049-496-595 (IEMI 357913001704853, shiko raportet e përgjimit në këto data dhe orë 8 Mars 2012, 14:09; 14 Mars 2012, 16:26, 15 Mars 2012 15:52 dhe 15:47; dhe 16 Mars 2012, 11:21 dhe 11:44). Trupi Gjykues nuk i beson shpjegimit të **RB** se fakti që ai bënë tregti me telefona vërteton apo mbështet mohimin e tij. Trupi Gjykues nuk beson se është koincidencë që të dy numrat kanë kontaktuar me 049-428-375. Numrat 049-820-521 dhe 049-428-375 kanë kontaktuar njëri tjetrin gjithsej 9 herë nga data 3 deri 8 Mars 2012. Numrat 049-496-595 dhe 049-428-375 kanë kontaktuar njëri tjetrin gjithsej 5 herë më 12 Mars 2012. Po të ishte shitur SIM

kartela bashkë me numrin e memorizuar nuk ka gjasa që një numër i panjohur të jetë kontaktuar aq shumë herë. Pas datës 12 Mars numri 049-428-375 nuk është regjistruar më.

27. **FA** mohon se e njeh furnizuesin e narkotikëve nga Shqipëria por pranon se e ka transportuar një njeri nga Shqipëria të cilin e njohte si “Ardi nga Kukesi” (Ardi) më 18 Mars 2012 nga Prizreni në Vushtrri (Procesverbali nga shqyrtimi gjyqësor i datës 24 Janar 2013 për **FA** (FA shqyrtimi gjyqësor) faqe 17). Ai e pranon se e njeh Ardin si klient të rregullt nga profesioni i tij si taksist (FA shqyrtimi gjyqësor faqe 20). Ai gjithashtu pranon se ka vozitur një Shqiptar tjetër i cili kishte thënë se Ardi ishte shoku i tij dhe i cili e kishte telefonuar Ardin për të konfirmuar se Ardi do ta paguaj udhëtimin nga Prizreni në Vushtrri (po aty). Ai gjithashtu pranon se ka pasur kontakt telefonik me Shqiptarin.
28. Përgjimet telefonike tregojnë një numër të cilin e kishte përdorur **FA**, 049-566-507 (numër pune), në kontakt me një numër të Shqiptarit të pretenduar (049-428-375) më 12 Mars 2012 (FA I Dyshuari faqe 2 dhe FA shqyrtimi gjyqësor faqe 29). Në tri raste kishte kontakt ndërmjet këtyre numrave (Përgjimet telefonike të datave 12 Mars 2012 në ora 22:49, 22:56 dhe 22:57). Kjo është e vetmja lidhje e qartë me **RB** i cili kishte komunikuar me Shqiptarin në numrin 049-428-375 nga numrat 049-425-895 dhe 049-965-595 në tetë përkatësisht pesë raste. Megjithatë, qëllimi dhe roli i **FA** nuk është i qartë
29. Rrëfimi i **FA** për dy udhëtime nga Prizreni në Vushtrri me “shokun” e Ardit nga Shqipëria ngritë çështjen e transportimit të narkotikëve (Intervista e të Dyshuarit FA e datës 8 Prill 2012 (I Dyshuari **FA**) faqe 4 dhe **FA** shqyrtimi gjyqësor faqe 21). Megjithatë, datat e këtyre udhëtimeve janë të paqarta nga dëshmia dhe përveç prezencës së një Shqiptari i cili bartte një çantë që lidhet me Ardin, nuk ka indikacione se në këto udhëtime ishte i përfshirë transportimi i narkotikëve, e lëre më të narkotikëve të sekuestruar më 18 Mars 2013.
30. Në përgjithësi, Gjykata konstaton se mohimet dhe identifikimi i Ardit nga **FA** janë të pabesueshme, u mungon besueshmëria themelore dhe paraqesin dëshmi tejet të paqartë. Po ashtu, prokuroria nuk ka arritur të ofrojë dëshmi të mjaftueshme për të provuar lidhjen dhe përfshirjen e tij në dërgesën e datës 18 Mars 2012.
31. Gjykata mund të vërtetojë si të dëshmuar vetëm lidhjen midis furnizuesit të narkotikëve dhe **RB**, kryesisht nëpërmjet dëshmisë së tij. Nuk ka mundësi të vërtetohet ndonjë lidhje me ndonjë bashkë-të-pandehur dhe të furnizuesit të narkotikëve për dërgesën më 18 Mars 2012.

*A e ka ditur FA se po transportonte substanca narkotike?*

32. I Pandehuri deklaron se nuk ka pasur dijeni për mallin që e bartnin me vete pasagjerët, Ai e përmend një rast që nuk lidhet me këtë kur një shok i Ardit nga Shqipëria ka pohuar se po bartte rrobe për të cilat nuk kishte paguar taksa doganore (FA shqyrtimi gjyqësor faqe 22). Ai identifikon dy udhëtime me këtë person, i cili e bartëte të njëjtën çantë, por që nuk e kishte ditur se çka kishte në të (procesverbali nga intervista e të pandehurit e datës 3 Maj 2012 (FA i Pandehuri) faqe 3). Megjithatë, nuk është paraqitur ndonjë provë për të treguar apo sugjeruar se ndonjë nga këto udhëtime ishte pjesë e ndonjë marrëveshje të organizuar për drogë..
33. Gjykata e pranon shpjegimin e tij për sjelljen e klientëve, ku nuk ka dyshim të arsyeshëm të ndonjë aktiviteti të paligjshëm taksisti nuk është i detyruar apo nuk ka të drejtë të dijë se çfarë bartë klienti apo përmbajtjen e valixheve të tij. Rrëfimi i tij për atë se si klientët rregullisht vendosin valixhet e tyre në bagazhin e taksit të tij pa ndihmën apo mbikëqyrjen e tij nuk është e paarsyeshme (FA shqyrtimi gjyqësor faqe 21). Madhësia e çantës që ishte përdorur vetvetiu nuk do të ngriste ndonjë dyshim. Substancat narkotike kanë kundërmim të fortë , megjithatë ato ishin të paketuara mirë në sasi dhe lokacion në veturë gjë që kishte bërë që të vështirësohet hetimi i tyre (Raporti i Analizës Forenzike; dhe fotografitë e Fotoalbumit 5, 6 dhe 9). Nuk është e paarsyeshme që narkotikët t'i kenë ikur hetimit të **FA**.
34. Përgjimet telefonike kanë treguar biseda të dyshimta ndërmjet **FA** dhe një njeriu që pohohet se ka qenë **AC**. Prokurori pohon se bisedat janë me kodim dhe kodimi i referohet sasisë dhe dërgesës së narkotikëve. Megjithatë, nuk është paraqitur ndonjë provë para Gjykatës që vërteton se bisedat në të cilat është përfshirë **FA** janë zhvilluar me kodim dhe se kodimi i referohet narkotikëve dhe shmangies së hetimit nga policia. Përgjimet të cilave u referohemi nuk kanë të bëjnë me dërgesën te **RB** më 18 Mars 2012 dhe Gjykata nuk ka dijeni për ndonjë veprim të zbatuar në lidhje me këto raste që do të tregonte ndërlidhjen ndërmjet disa fjalëve të koduara dhe narkotikëve. Asnjë përgjim ku janë përdor fjalë të ngjashme nuk lidhet me dërgesën e datës 18 Mars 2012 që do të mundësonte të arrihet një konkluzion i qartë. Në rastin më të mirë provat e paraqitura janë jothelbësore.
35. Përkundër dëshmisë së paqartë dhe të diskutueshme të **FA**, nuk ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar se ai dinte apo kishte njohuri konstruktive deri në

nivelin e nevojshëm të probabilitetit se ai po transportonte narkotikë më 18 Mars 2012 për të përmbushur testet ligjore të qëllimit.

Përmbledhje e fakteve të vërtetuara

36. Faktet në vijim janë vërtetuar:

Para datës 16 Mars 2012 **RB** kishte takuar furnizuesin e narkotikëve nga Shqipëria në Mitrovicë te një “auto-larje”.

Para datës 16 Mars 2012 **RB** ishte në kontakt me furnizuesin e narkotikëve nga Shqipëria për të rregulluar dërgesën e 6 kg kanabis.

Më apo para datës 16 Mars 2012 **RB** dhe **FT** ishin pajtuar të blinin narkotikët dhe t’ia shitnin ato një tregtuesi të drogës të quajtur Nenad.

Më apo para datës 16 Mars 2012 **RB** dhe **FT** kishin mbledhur 3000 euro për t’i paguar substancat narkotike.

Më 16 Mars 2012 **RB** e kishte takuar furnizuesin e narkotikëve për ta finalizuar dërgesën për datën 18 mars 2012. Në rrugën Ferizaj Prishtinë te QMI-a ai kishte paguar 3000 euro për dërgesën.

Më 18 Mars 2012 **RB** kishte marrë dërgesën nga një kurir në fshatin Smrekovnicë.

Më 18 Mars 2012 **RB** kishte transportuar narkotikët në Mitrovicë për t’u takuar me **FT**.

Më 18 Mars 2012 **RB**, **FT** dhe **LK** janë arrestuar te supermarketet Viva Fresh dhe ETC. Dërgesa e 5.546 neto kg të narkotikëve (kanabis) është sekuestruar nga bagazhi i veturës Mercedes i bardhë (regjistrimi 02-197-AG) të cilën e kishte përdorur **RB** për t’i transportuar narkotikët.

Më 6 Prill 2012 **AC** dhe **FA** janë arrestuar në Prizren nën dyshimin e veprës së akuzuar.

E. Kualifikimi Ligjor. Përgjegjësia Penale. Dënimi i Shqiptuar.

**Ligji**

37. Në përputhje me Nenin 3(2) të KPRK Gjykata ka vendosur se dispozitat e KPRK janë më të favorshmet. Përveç kësaj Gjykata nuk i detyrohet klasifikimit ligjor të veprave nga Prokuroria (Neni 360(2) i KPP).

Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i drogave narkotike, substancave psikotrope apo analoge

38. Dispozitat përkatëse të Nenit 273 që konsiderohen nga Gjykata janë:

“1. Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë...

2. Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon ose dërgon në transit substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë.... me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje...”

39. Gjykata konsideron se “ndërmjetëson” nga Neni 273(2) i KPRK mund ta mbulojë situatën kur arrihet një marrëveshje ndërmjet dy aktorëve kryesor, nuk është e domosdoshme që aktiviteti të përfshijë kryerësin vetëm si ndërmjetësues në ndonjë marrëveshje ndërmjet dy aktorëve tjerë kryesor. Në gjuhën angleze folja “ndërmjetëson” do të thotë të rregullosh apo negociosh një marrëveshje ndërsa versioni në gjuhën shqipe i KPRK i referohet kësaj si “ndërmjetëson” që në gj. Angleze përkthehet si “mediates”. Kjo do të thotë që aktiviteti është më i gjerë se sa vetëm ai që kryhet nga një negociatës apo ndërmjetësues dhe mund të përfshijë dy aktorët kryesor në një marrëveshje.

40. Gjykata ka parasysh elementin thelbësor të qëllimit për t’i shpërndar, shitur apo ofruar për shitje të narkotikëve.

41. Përveç kësaj Gjykata ka marrë në konsiderim Nenin 281(1) dhe (1.1) të KPRK:

“1. Nëse vepra penale nga Neni 273.... të këtij Kodi kryhet në një ose më shumë nga rrethanat në vijim, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet, nëse:

1.1 kryesi vepron si anëtar i grupit”

Grupi më tej përkufizohet si, “... tre (3) apo më shumë persona.” (Neni 120(12) i KPRK).

42. Gjykata nuk konsideron se të gjitha anëtarët e grupit duhet të identifikohen dhe gjykohen së bashku që të konsiderohen grup. Përveç kësaj grupi nuk duhet domosdo të jetë hierarkik apo organ shumë i organizuar. Si në këtë rast, grupi mund të jetë një asociacion joformal që bëhet bashkë për një aktivitet të vetëm. Anëtarët individual të grupit mund të kenë motivime dhe nxitje të ndryshme, por prap klasifikohet si grup, nëse përpjekjet e tyre kontribuojnë drejt një kursi të vetëm të sjelljes kundërvajtëse. Më tej, Gjykata konsideron se nuk është e nevojshme që brenda një "grupi", në kuptim të Nenit 281 të KPRK, secili anëtar ta njeh tjetrin dhe rolet e sakta të atyre që janë të përfshirë. Rolet e përcaktuara për anëtarët nuk janë të domosdoshme dhe grupi nuk do të thotë që duhet të ekzistojë për një periudhë të gjatë kohore. Grupi gjithashtu mund të ketë aktorët kryesor dhe ndihmësit, si për shembull, bartësit në transportimin e drogës. Nuk është e detyrueshme që anëtarët tjerë të grupit të jenë të akuzuar apo dënuar. Arsyeja për dënim më të lartë për anëtarët e një grupi qëndron në rrezikun e të vepruarit në grup. Brenda një grupi secili anëtarë ka vullnetin e detyrueshëm për ta kryer veprën penale që e bënë të vështirë që anëtari ta ndërrojë mendjen dhe të abstenojë nga kryerja e veprës penale. Ekziston rregullisht mundësia e ndikimit në një anëtar nga të tjerët. Ky rrezik potencial ekziston edhe kur anëtari nuk e njeh shefin e grupit apo anëtarët tjerë.
43. Këtu, së pakut 4 persona kanë qenë të përfshirë në kryerjen e veprës penale dhe rolet e anëtarëve të grupit ishin mjaft të qarta: një furnizues, një kurir, bashkë me **RB** dhe **FT**.
44. Ligji për Barnat Narkotike, Substanca Psikotrope dhe Perkurësorë (Ligji Nr. 02/L-128) (NMPP) merret me autorizimin e posedimit, përdorimit dhe shpërndarjes e substancave të kontrolluara. Është e qartë se kanabisi ( që njihet edhe si Marihuanë) është i ndaluar në Kosovë (shiko Nenet 9.1 dhe 9.2, dhe Tabelën I të BNPP. Vetëm personat fizik dhe juridik të përfshirë në hulumtimin mjekësor dhe shkencor, për qëllime edukative apo policore mund të marrin leje për të blerë, furnizuar apo poseduar kanabis- Tabela I e narkotikëve të klasifikuar (Nenet 16.1 dhe 17.1 të BNPP). Importuesi apo eksportuesi i kanabisit gjithashtu ka nevojë të jetë i licencuar dhe vetëm personat juridik mund të licencohen (Neni 19.1 BNPP).

45. Sa i përket dashjes kjo përcaktohet me Nenin 21 të KPRK:

“1. Vepra penale mund të kryhet me dashje direkte ose eventuale.

2. Personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj.

3. Personi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj

46. Gjykata mund ta nxjerr dashjen nga rrethanat faktike të rastit (Neni 22 i KPRK). Për ta vërtetuar dashjen eventuale Gjykata konsideron se kërkohet një shkallë e lartë e parashikimit të pasojës së ndaluar por më pak se siguria. Ajo duhet të jetë e dallueshme nga pakujdesia.

47. Siç përcaktohet me ligj dashja mund të nxirret nga rrethanat dhe provat e rastit. Për të pasur dashje duhet të ketë njohuri. Gjykata konsideron se kjo përfshinë rrethanat kur i pandehuri është qëllimisht i verbër – qasja e papranueshme "mos pyet, mos trego" që miratohet lehtë në raste të kontrabandës. Gjykata ka parasysh miratimin e kësaj qasje nga të pandehurit në rastet penale nga juridiksionet tjera (p.sh Shtetet e Bashkuara kundër Heredia, 483 F.3d 913 (rreth e nëntë) (en banc), vërt. mohuar, 76 U.S.L.Ë. 3303 (SHBA. 11 Dhjet. 2007) (Nr. 07-5762); Shtetet e Bashkuara kundër Nicholson, 677 F.2d 706, 711 (Rreth. 9të 1982); *Taylor's Central Garages (Exeter) Limited v Roper*, Raportet e Rishikimit të Qeverisë Lokale vll. 115, f. 445 (U.K.); dhe *Atéal kundër Massey*, 56 Cr. App. R 6 (U.K.)).

48. Kjo do të përbënte dashjen eventuale nga Neni 21(3) i KPRK dhe duhet të dallohet nga pakujdesia dhe neglizhenca nga Neni 23 e KPRK. Nuk ka dispozitë për pakujdesinë nga veprat e Nenit 273.

49. Për ta vërtetuar verbërinë e qëllimshme apo njohurinë konstruktive duhet të jenë prezent këta faktor, i pandehuri: 1/ ka pasur dyshim aktiv se ka pasur aktivitet kriminal; 2/ ka kuptuar mundësinë e lartë për aktivitetin e dyshuar kriminal; 3/ me qëllim iu ka shmangur konfirmimit të dyshimit të tyre; dhe 4/ nuk ka arritur ta konfirmojë dyshimit e tyre për ta ruajtur mbrojtjen ndaj çdo ndjekje të mëvonshme. Njohuria e të pandehurit duhet të vërtetohet në mënyrë subjektive. Njohuria konstruktive nuk do të jetë çështje kur mohim i diturisë është kryesisht çështje e besueshmërisë së rrëfimit të të pandehurit.

50. Vërtetimi i njohurisë konstruktive mjafton për ta krijuar vetëdijen e nevojshme për dashjen eventuale nga Neni 21(3) i KPRK.

51. Së fundi, të Pandehurit janë akuzuar se kanë vepruar në bashkë-kryerje që përkufizohet si:

“Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.” (Neni 31 i KPRK)

Bashkë-kryerja dhe veprimi në grup nuk konsiderohen reciprokisht përjashtuese. Bashkë-kryerja lejon aktivitetin kumulativ apo të përbashkët të së pakut dy personave për të përmbushur elementet e një vepre. Në këtë rast veprimi në grup është më shumë faktor rëndues që e rritë dënimin e mundshëm se sa thelbësor për vërtetimin e përgjegjësisë penale.

## **Përgjegjësia penale e të Pandehurve**

### **RB**

52. **RB** me njohuri të plotë ka vepruar me **FT** në blerjen e një sasive të madhe të narkotikëve nga një furnizues droge nga Shqipëria. Me **FT** ai ka mbledhur 3.000 eurot e kërkuara.

53. Para datës 18 Mars 2012 ai ka kontaktuar Shqiptarin dhe ka bërë organizimin e dërgesës së narkotikëve për t'u dërguar në Mitrovicë. Më 16 Mars 2012 ai ka bërë pagesën e dërgesës në periferi të Prishtinës. Ai ka rregulluar takimin me kuririn e dërgesës në fshatin Smrekovicë dhe ka sjellur drogat në pjesën e prapme të veturës që e kishte huazuar te supermarketi Viva Fresh në Mitrovicë (RB shqyrtimi gjyqësor faqe.18). Ai kishte planifikuar të takohej me **FT** në Mitrovicë. Ai është arrestuar te supermarketi Viva Fresh dhe narkotikët janë sekuestruar nga vetura të cilën po e ngiste.

54. Është e qartë se ai e kishte dëshiruar blerjen dhe posedimin e narkotikëve të ndaluar. Veprimet e tij për rregullimin e dërgesës së narkotikëve, bashkë-punimi i tij me **FT**, blerja dhe transportimi i narkotikëve të gjitha tregojnë dashjen e tij për t'i shpërndarë dhe shitur narkotikët më tej një blerësi të panjohur me të cilin **FT** kishte negociuar një marrëveshje. Veprimet e tij për blerjen dhe transportimin e narkotikëve dhe negocimin e marrëveshjes me Shqiptarin janë të gjitha veprime të mjaftueshme për të qenë elemente aktive të veprës nga Neni 273(2) i KPRK. Ai nuk kishte leje për autorizimin e posedimit të narkotikëve.
55. Të lartcekurat janë vërtetuar në bazë të këtyre provave: certifikata e gjësendeve të konfiskuara nga **RB** e datës 18 Mars 2012; Raporti i analizës Forenzike; dëshmia e ekspertit **SD** dhe deklaratat e këtij të Pandehuri dhe e të Pandehurit **FT**.
56. I Pandehuri ka tentuar ta përdor në mbrojtjen e tij faktin se ai nuk ishte në dijeni se marrja me marihuanë është e ndaluar me ligj. Trupi Gjykues konstaton se pohimi i tij është tejet i pabesueshëm, duke marrë parasysh faktin se ai dhe furnizuesi i tij kishin ndërmarrë shumë masa paraprake kur ishin takuar për të këmbyer paratë apo drogat. Gjithashtu, Trupi Gjykues ka parasysh parimin "*Ignorantia juris non excusat*" i cili do të thotë se personi që nuk ka njohuri për ligjin nuk mund t'i ik përgjegjësisë për shkeljen e atij ligji kryesisht për shkak se ai apo ajo nuk kanë pasur njohuri për përmbajtjen e tij.
57. Veprimet dhe dashjet e **RB** janë të qarta dhe plotësojnë elementet e veprës nga Neni 273(2) të KPRK. Ai ka vepruar me **FT** si bashkë-kryerës në kryerjen e veprës (Neni 31 i KPRK).
58. Edhe pse motivimi dhe roli i Shqiptarit ishte i ndryshëm nuk mjafton që përfshirja e tij të jetë pjesë e bashkë-kryerjes së **RB** dhe **FT** për të krijuar një grup nga Nenet 120(12) dhe 281(1.1) të KPRK. Shqiptari kishte ndërmjetësuar në marrëveshjen për narkotikë me **RB** dhe kishte dërguar dërgesën e 18 Marsit 2012.
59. **RB** është fajtor për bashkë-kryerje në grup të veprës Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i drogave narkotike, substancave psikotrope apo analoge nga Nenet 31, 273(2) dhe 281(1.1) e KPRK në përputhje me Nenin 362 të KPP.

## **FT**

60. Bashkë- i Pandehuri ka pranuar se është fajtor dhe ka bërë një marrëveshje për pranimin e fajësisë. Ai ka pranuar dëshirën e tij për blerjen e narkotikëve me **RB** me qëllim për ta shpërndarë atë mëtej në Mitrovicë një tregtuesi të panjohur droge të identifikuar si “Nenad”. Qëllimi i tij e qartë ishte të shesë dhe dërgojë narkotikë te një palë e tretë. Ai tashmë kishte ndërmjetësuar një rregullimin e kësaj marrëveshje të mëtejme. Kjo në vetvete paraqet elementet mendore dhe aktive të veprës nga Neni 273(2) i KPRK.
61. Po ashtu, Trupi Gjykses konsideron se i Pandehuri **FT** ka vepruar në bashkë-kryerje në transportimin e narkotikëve. Është element thelbësor i veprës fakti se ekziston dashja për të shpërndarë, ofruar për shitje apo shitje të narkotikëve. **FT** kishte bërë marrëveshjen e mëtejme me “Nenadin” për blerjen e narkotikëve që i transportonte **RB**. Pa këtë marrëveshje të mëtejme është në pikëpyetje nëse **RB** do t’i kishte shitur dhe transportuar narkotikët me të cilët ishte arrestuar më 18 Mars. **FT** ishte kyç dhe pjesëmarrja e tij ishte thelbësore në vepër që vërteton dashjen e të dy të Pandehurve për t’i ofruar narkotikët për shitje.
62. Me vetëdije të plotë ai ka punuar me **RB** për të mbledhur fondet për blerjen e narkotikëve. Ai ka vepruar me **RB** si bashkë-kryerës në kryerjen e veprës. Ai nuk ka pasur leje me të cilën autorizohej blerja apo posedimi i narkotikëve. Me **RB** dhe Shqiptarin ai ka vepruar si grup sipas Neneve 120(12) dhe 281(1.1) të KPRK.
63. Këto që u cekën më lart janë vërtetuar në bazë të këtyre provave: certifikatës për konfiskimin e gjësendeve nga **RB** e datës 18 Mars 2012; raportit të analizës forenzike; dëshmisë së ekspertit Sokol Dedaj dhe deklaratave të këtij të Pandehuri dhe të Pandehurit **RB**.
64. **FT** është fajtor për bashkë-kryerje në grup të veprës Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i drogave narkotike, substancave psikotrope apo analoge nga Nenet 31, 273(2) dhe 281(1.1) të KPRK në përputhje me Nenin 362 të KPP.

## AC

65. Prokurori e ka pasur të pamundur që ta lidhë në mënyrë të mjaftueshme të Pandehurin me veprimet e bashkë-të-pandehurve **RB** dhe **FT**.
66. Me rastin e arrestimit të tij, Policia ka sekuestruar nga **AC** një SIM kartelë me numrin 049-484-628 (faqe 294 të shkresave të lëndës); ky është numri me të cilin Prokuroria ka provuar të demonstrojë se **AC** ia kishte treguar **S** si numri i tij i ri telefonik (pretendohet se pas arrestimit të grupit të parë të të pandehurve ai ka ndryshuar numrat); ajo që është relevante është se “shpallja e ndryshimit të numrave” pretendohet i ishte bërë **S** përmes një telefonate që ishte bërë nga numri 049-428-375; ky numër (049-428-375) kontestohet nga **AC** dhe sa i përket atij urdhri për masa të fshehta ishte lëshuar në emër të të ashtu-quajturit “Kukësi”. Megjithatë, për të vërtetuar se **AC** e kishte përdorur numrin 049-428-375 për t’ia lajmëruar **S** ndryshimin e numrave, prokuroria i referohet raportit policor (faqet 187-190 shkresat e lëndës); kjo në të vërtetë është një kërkesë e policisë për të urdhëruar masat e fshehta që në arsyetimin e saj ceket se ekzistojnë përgjime lidhur me këtë ndryshim të numrave, prandaj, ata duan t’i regjistrojnë edhe numrin e ri (049-484-628); ne nuk kemi ndonjë përgjim të vërtetë apo tjetër për të vërtetuar dhe mbështetur kërkesën e policisë se **AC** kishte ndërruar numrin nga 049-428-375 në 049-484-628.
67. Një provë tjetër e mundshme për të mbështetur se **AC** kishte përdorur numrin 049-428-375 është dëshmia e zyrtarit policor **NB**; ai përmend se Policia kishte përgjuar **AC** dhe **RB** duke biseduar për takimin me njëri tjetrin; kjo, plus fakti se policia i kishte vëzhguar ata kur ishin takuar më 16 Mars 2012, gjithashtu vërteton të dhënat personale të **AC** të marra në kufirin për në Shkup e çon atë në këtë përfundim se **AC** ishte ai që ishte takuar me **RB** dhe që kishte përdorur telefonin e përgjuar; megjithatë, ne nuk i kemi këto biseda të pasqyruara në transkripte; ekzistojnë vetëm dy SMS-a më 16 Mars 2012 pasqyruar në përmbledhjen e transkripteve, por nuk ka transkripte individuale për ta; më 14 Mars 2012 ka disa komunikime ndërmjet **RB** dhe dy numrave nga Shqipëria lidhur me disa “veprime” dhe “lëvizje”. Megjithatë, nuk ka absolutisht asnjë dëshmi bindëse se numrat nga Shqipëria janë përdorur nga **AC** dhe kjo, sipas dëshmitarit **NB**, është kryesisht supozim i bërë nga Policia.
68. Ndërmjet datës 3 dhe 12 Mars 2012 ka pasur komunikime ndërmjet numrit 049-428-375 dhe **RB** (049-425-895 – numër i konfirmuar nga IPKO, faqe 235 shkresat e lëndës) lidhur me bisedat e qarta të koduara lidhur me sasi të narkotikëve, dërgesave, gjendjen e rrugës (e lirë/jo e lirë) dhe praninë e policisë, përfshirë 3 thirrjet e para të përmbledhura në faqen 228 që në fakt datojnë nga 6 Mars 2012 e jo nga 19 Mars 2012 siq ishte vënë gabimisht data në lëndë. Megjithatë, këto nuk mund të sjellin asnjë provë tjetër sa i përket lidhjet ndërmjet **AC** dhe numrit të përgjuar.

69. Andaj, dëshmia e përgjimit është jo bindëse sa i përket identitetit të personit që ka thirrur dhe nuk ka kontakt të drejtpërdrejtë të vërtetuar ndërmjet të Pandehurit dhe bashkë-të-Pandehurve të dënuar lidhur me dërgesën e narkotikëve më 18 Mars 2012.
70. I Pandehuri nuk është parë në posedim apo organizim të importimit të narkotikëve në Kosovë dhe rreth Kosovës. Po ashtu, ai nuk është identifikuar nga bashkë-të-Pandehurit **RB** dhe **FT** si Shqiptari që ka furnizuar me narkotikë. Gjykata e konsideron mohimin e kontaktit ndërmjet **RB** dhe **AC** si të pabesueshme. Megjithatë, për arsyet e cekura më lartë, takimi ndërmjet **RB** dhe **AC** i parë nga zyrtari policor Bislimi më 16 Mars 2012 është i pamjaftueshëm për ta bazuar dënimin përtej dyshimit të arsyeshëm.
71. Asnjë vëzhgim apo hetim financiar apo provë tjetër nuk ka treguar ndonjë lidhje me dërgesën e narkotikëve më 18 Mars 2012.
72. Një fakt tjetër i cili rritë pasigurinë se **AC** dhe furnizuesi nga Shqipëria janë i njëjti personi është se **RB** në deklaratën e tij thotë se Shqiptarit i kishte dorëzuar 3.000 Euro kur ishte takuar me të të rrethi. **AC** nuk ishte në posedim të kësaj shume parash kur ishte paraburgosur nga policia të njëjtën ditë në pikën kufitare me Maqedoninë.
73. Kjo pasiguri vërtetohet më tej faktin se Gjykata nuk ka mundur ta konstatojë si të vërtetuar se i Akuzuari ishte i përfshirë në transportimin e drogës së sekuestruar më 18 Mars 2012. Ky dyshim dhe prezenca e zgjidhjeve tjera alternative të mundshme dhe të besueshme duhet të interpretohet në favor të të Akuzuarit, në bazë të parimit *in dubio pro reo*.
74. Në bazë të këtij parimi, barra e vërtetimit inkorporuar në obligimin e Prokurorisë për të vërtetuar fajësinë e të Pandehurit përtej dyshimit të arsyeshëm do të thotë se duhet të vërtetohet dhe dëshmohet se nuk ka alternative tjera të arsyeshme nga ajo që demonstron nga Prokurori. Siç sqarohet nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) në rastin *Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës*, lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë, Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj): "Pargrafi 2 [i Neni 6] inkorporon parimin e prezumimit të pafajësisë. Kërkohej, inter alia, që gjatë kryerjes së detyrave të tyre, anëtarët e një gjykate nuk duhet të fillojnë me idenë e paragjykuar se i Akuzuari ka kryer veprën për të cilën

akuzohet; barra e vërtetimit bie mbi Prokurorinë, dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të Akuzuarit.”<sup>1</sup> Prandaj, ky parim është esencial për të drejtën e prezumimit të pafajësisë derisa të vërtetohet fajësia sipas ligjit. Rrjedhimisht, në bazë të parimit *in dubio pro reo*, Gjykata, gjatë vlerësimit të fakteve dhe provave, duhet të vendos në favor të të Akuzuarit në rast dyshimi.

75. Në bazë të asaj që u cek më lartë, akuza ndaj të Pandehurit nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm dhe ai shpallet i pafajshëm dhe lirohet nga akuza (Neni 364(1.3) e KPP).

## **FA**

76. Gjatë vlerësimit të përgjimeve, Gjyakta ka parasysh këto:

Sipas certifikatës së IPKO-s (faqe 235 shkresat e lëndës) bashkë me deklaratën e të Pandehurit të datës 24 Janar 2013, një nga numrat që përdor ai është 049-566-507; ky numër pasqyrohet në transkriptet në faqet 259, 263 dhe 265 të shkresave të lëndës.

Më 12 Mars 2012 ndërmjet këtij numri, numrit të **RB** 049-425-895 dhe numrit 049-428-375 ka pasur biseda të shpeshta lidhur me atë se a kanë arritur të kalojnë përmes filtrit të policisë, duke ngarë veturat njëri pas tjetrit, duke koordinuar lëvizjet, etj. Megjithatë, nuk ka pasur komunikim të drejtpërdrejt ndërmjet **FA** dhe **RB**, gjithçka ka shkuar përmes numrit 049-428-375 dhe mund të lidhet me transportimin e drogës më 18 Mars 2012.

77. Gjithashtu, siç u paraqit më lartë, Gjykata nuk mund ta përjashtojë shpjegimin e të Pandehurit lidhur me sjelljen e klientëve, kur nuk ka dyshim të arsyeshëm të veprimit ilegal, taksisti nuk është i obliguar dhe nuk ka të drejtë të dijë se çka bartë klienti apo përmbajtjen e valixhes së tij. Rrëfimi i tij se klientët i vendosin valixhet në bagazhin e taksit të tij pa ndihmën apo mbikëqyrjen e tij nuk është i paarsyeshëm (FA shqyrtimi gjyqësor faqe 21). Madhësia e çantës së përdorur nuk do të linte ndonjë dyshim në vetvete. Narkotikët kanë kundërmim të fortë dhe të dalluar, megjithatë, ato kanë qenë të paketuara mirë, në sasi dhe vend në veturë që do ta bënë të vështirë hetimin e tyre (Raporti i analizës forenzike; dhe fotografitë e fotoalbumit 5, 6 dhe 9). Nuk është e paarsyeshme që narkotikët kanë mundur t'i shmangen hetimit nga **FA**.

---

<sup>1</sup> A 146 (1989); 11 EHRR 360 para 77 PC;

78. Prandaj, vihet në përfundim se nuk ka prova të mjaftueshme për të treguar se **FA** ka transportuar narkotikët më 18 Mars 2012 apo se ka ditur që po transportonte narkotikët në raste të mëparshme. Gjykata ka marr në konsiderim provat e lartcekura dhe nuk mund të konkludojë as dashjen direkte as eventuale për transportimin e narkotikëve.

79. Për këto arsye, elementet mendore dhe aktive të akuzës ndaj tij nuk janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Gjykata i referohet konsideratës lidhur me parimin *in dubio pro reo* siç paraqitet për të Pandehurin **AC**. Ai shpallet i pafajshëm dhe lirohet nga akuzat kundër tij (Neni 364(1.3) të KPP-së).

### **LK**

80. Konsiderohet si e vërtetuar se i Pandehuri nuk ishte i përfshirë me dashje apo nga pakujdesia në ndonjë veprim kriminal dhe Prokurori ka tërhequr aktakuzën kundër tij sipas Nenit 52 të KPP.

81. Akuzat kundër tij refuzohen në përputhje me Nenin 363(1.1) të KPP.

### **Dënimi**

82. Një vepër nga Neni 273(2) i KPRK bartë dënimin me gjobë dhe burgim nga (2) deri në (12) vjet. Periudha e dënimit rritet në tri (3) deri në pesëmbëdhjetë \*15) vjet kur vepra kryhet në grup– si në këtë rast (Neni 281(1.1) o KPRK).

83. Gjykata iu ka përmbajtur rregullave dhe faktorëve për llogaritjen e dënimit sipas Neneve 73 -74 të KPRK.

## **RB**

84. Gjykata ka parasysh se ai ka nxitur dërgesën e narkotikëve dhe ka marr rolin udhëheqës në organizimin e blerjes dhe dorëzimit të narkotikëve. Ai e ka bërë këtë për përfitim personal. Por, që nga arrestimi i tij ai ka qenë i hapur lidhur me përfshirjen e tij. Megjithatë, ai nuk ka ndihmuar plotësisht në hetimin për të kapur dhe ndjekur kryerësit tjerë.
85. Si masë lehtësuese Gjykata ka pasur parasysh bashkëpunimin e tij të kufizuar në hetim, pendimin dhe pranimin e përgjegjësisë penale për pjesën e veprimeve të tij (Neni 74(3.9) dhe (3.11) të KPRK). Gjykata ka marrë në konsiderim llojin e narkotikëve të sekuestruar dhe sasinë që konsiderohet të jetë furnizim i vogël. I Pandehuri nuk ka dënime paraprake. Sipas Nenit 76(1.3) të KPRK, Gjykata mund të zvogëlojë dënimin minimal me burg deri në 1 vit.
86. Në bazë të këtyre faktorëve, Gjykata shqipton dënimin me gjobë prej 30 Euro dhe dënimin me burg prej 1 vjet e 6 muaj.
87. Sipas Nenit 83 të KPRK e tërë koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak, apo çdo heqje tjetër e lirisë duhet të merren parasysh në llogaritjen e dënimit përfundimtar. I Pandehuri është paraburgosur më 18 Mars dhe është mbajtur në paraburgim deri më 17 Shtator 2012, kur është mbajtur në arrest shtëpiak derisa kjo masë ka skaduar më 17 Janar 2013.

## **FT**

88. Gjykata ka parasysh se ai ka qenë bashkë-kryerës me dashje dhe kryesor. Pa kontributin e tij, me gjasë **RB** nuk do të kishte vazhduar më tutje. **FT** ishte qenësor në negociimin e marrëveshjes me tregtuesin e drogës t quajtur Nenad të cilit do t'i shitej dërgesa me narkotikë e datës 18 Mars 2012. Ai e ka bërë këtë për përfitim personal. Por, që nga arrestimi i tij ai ka qenë i hapur lidhur me përfshirjen e tij dhe ka pranuar fajësinë në mundësinë e parë.
89. Si masë lehtësuese Gjykata ka parasysh bashkëpunimin e plotë të tij në hetim, pendimin dhe pranimin e përgjegjësisë penale për pjesën e veprimeve të tij (Neni 74(3.9), (3.10) dhe (3.11) i KPRK). Gjykata ka marrë në konsiderim llojin e

narkotikëve të sekuestruar dhe sasinë që konsiderohet të jetë furnizim i vogël. Roli i **FT** në vepër ishte më i vogël se ai i **RB**. I Pandehuri nuk ka dënime paraprake. Sipas Nenit 76(1.3) të KPRK, Gjykata mund të zvogëlojë dënimin minimal me burg deri në 1 vit.

90. Në bazë të këtyre faktorëve, Gjykata shqipton dënimin me gjobë prej 30 Euro dhe dënimin me burg prej 1 viti.

91. Sipas Nenit 83 të KPRK e tërë koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak, apo çdo heqje tjetër e lirisë duhet të merren parasysh në llogaritjen e dënimit përfundimtar. I Pandehuri është paraburgosur më 18 Mars dhe është mbajtur në paraburgim deri më 17 Shtator 2012, kur është mbajtur në arrest shtëpiak derisa kjo masë ka skaduar më 17 Janar 2013.

### **Konfiskimi**

92. Sasia prej 5546.4g (neto) e narkotikëve të sekuestruar më 18 Mars 2012 është konfiskuar dhe shkatërruar në përputhje me Nenet 69 dhe 273(5) të KPRK dhe me Nenin 31 të Ligjit për Barnat Narkotike, Psikotrope dhe Prekursorë.

93. Në përputhje me Nenin 69 të KPRK gjësendet e sekuestruara nga të Pandehurit e dënuar **RB** dhe **FT** janë konfiskuar duke qenë se janë përdorur në veprën penale:

1. Vetura Mercedes me ngjyrë të bardhë (regjistrimi 02-197-AG)
2. Telefoni Samsung me ngjyrë të zezë (IMEI 352025/04/978394/2)
3. SIM kartela IPKO për numrin 049-425-895 (Nr. i SIM kartelës 107010520941)
4. Telefoni Sony Ericsson me ngjyrë të bardhë (IMEI 35791301-704853-2)
5. SIM kartela IPKO për numrin 049-496-595 (Nr. i SIM kartelës 109011667200)
6. Telefoni Nokia me ngjyrë të zezë (IMEI 355956/04/366377/6)
7. SIM kartela VALA për numrin 044-218-808 (Nr. i SIM kartelës 8937701010011760689)
8. Telefoni Nokia me ngjyrë të zezë (IMEI 356841/02/844547/3)
9. SIM kartela Mobtel për numrin 065-5777-631 (Nr. i SIM kartelës 89381030000144638097)
10. SIM kartela Vodafone (Nr. i SIM kartelës 60610988028631G01520)
11. SIM kartela VALA (Nr. i SIM kartelës 89377010100016521508)
12. SIM kartela Mobtel (Nr. i SIM kartelës 89381030000143222943)

-----  
Roxana Comsa  
Kryetare e Trupit Gjykses  
Gjyqtare e EULEX-it

-----  
John Gayer

Procesmbajtës

Zyrtar Ndërkombëtar Ligjor i EULEX-it

**Mjeti Juridik: Prokurori, të Pandehurit apo Avokatët Mbrojtës Ankesën kundër këtij Aktgjykimi duhet ta paraqesin brenda 15 ditësh nga dita e pranimit (Neni 380(1) i KPP). Çdo Ankesë për Gjykatën e Apelit duhet të paraqitet në Gjykatën Themelore dhe në mënyrën e përcaktuar me Nenet 376 dhe 382 të KPP.**